

VENDIM
Nr. 15, datë 20.1.2016

**PËR NJË SHITESË FONDI NË BUXHETIN E VITIT 2016, MIRATUAR PËR
DREJTORINË E SHËRBIMEVE QEVERITARE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5 e 45, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, dhe të ligjit nr. 147/2015, “Për buxhetin e vitit 2016”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në buxhetin e vitit 2016, miratuar për Drejtorinë e Shërbimeve Qeveritare, programi “Shërbime qeveritare”, të shtohet fondi prej 178 636 736 (njëqind e shtatëdhjetë e tetë milionë e gjashtëqind e tridhjetë e gjashtë mijë e shtatëqind e tridhjetë e gjashtë) lekësh, për rikonstruksionin e pjesshëm të Pallatit të Kongreseve, në Tiranë, në kuadër të organizimit të Asamblesë Parlamentare të NATO-s, në datat 27–30 maj 2016, në Tiranë.

2. Ky fond të përballohet nga fondi rezervë i buxhetit të shtetit i vitit 2016.

3. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Drejtoria e Shërbimeve Qeveritare për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Edi Rama